



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark"
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. 94 Prot

Tiranë më, 18 . 02 .2021

K Ë R K E S Ë

DREJTUAR: GJYKATËS KUSHTETUESE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Blv. "Dëshmorët e Kombit" Nr. 26

TIRANË

KËRKUES: AVOKATI I POPULLIT I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Blv. "Zhan D'Ark" Nr. 2

TIRANË

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Blv. "Dëshmorët e Kombit", Nr. 4

TIRANË

2. PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Blv. "Dëshmorët e Kombit"

TIRANË

3. KËSHILLI I MINISTRAVE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Blv. "Dëshmorët e Kombit", Nr. 7

TIRANË

OBJEKTI: 1. Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut, i nenit 8 të ligjit nr. 133/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar.

2. Pezullimi i menjëhershëm i zbatimit të nenit 8 të ligjit nr. 133/2020, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, deri sa vendimi përfundimtar i Gjykatës Kushtetuese të hyjë në fuqi, me qëllim parandalimin e pasojave që mund t’u shkaktohet shtetasve nga aplikimi i masave të veçanta nga strukturat e Policisë së Shtetit.

BAZA LIGJORE:

- Nenet 7, 15/1, 17, 31, 35, 36, 37/2, 42/2, 44, 116, 131/a dhe 134/1/çtë Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë - e ndryshuar;
- Nenet 8 dhe 15 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut;
- Nenet 27, 45/1, 49/1 dhe 50/1 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” - i ndryshuar;
- Neni 24/c i Ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” - i ndryshuar.

Të nderuar gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë!

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (Kuvendi) ka miratuar ligjin nr. 133/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar”.

Nga dokumentacioni i publikuar në faqen zyrtare të Kuvendit rezulton se paraprakisht projektligji është shqyrtuar në Komisionin për Sigurinë Kombëtare në cilësinë e komisionit përgjegjës dhe në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike

dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, pasi ka ardhur si nismë propozuese e Këshillit të Ministrave dhe e një deputeti.

Duke iu referuar raporteve të Komisioneve përkatëse, rezulton se projektligji ka patur si qëllim kryesor të krijojë mundësinë ligjore që strukturat e Policisë së Shtetit të përdorin me efektivitet masa të veçanta, duke bërë shtesa e ndryshime në nenet 6, 7, 17, 19, 45, 84 dhe 131, të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, në luftën kundër krimit të organizuar, krimeve të rënda si dhe krimeve në fushën financiare, ndërkohë që ky qëllim nuk na rezulton të jetë reflektuar në përmbajtjen e dispozitave të ligjit të miratuar. Kjo pasi parashikimet e reja ligjore nuk aplikohen vetëm gjatë veprimtarisë parandaluese për veprat e sipërcituara, por lejohen pa kufizim dhe nuk shpjegohet se përse procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale nuk plotësojnë nevojën e kësaj force, për të qenë efektive në këtë veprimtari.

Në përmbushje të misionit të tij kushtetues e ligjor, Avokati i Popullit ka shprehur në vijimësi në media qëndrimin dhe shqetësimin e tij institucional lidhur me projektligjin në fjalë duke evidentuar se disa dispozita të tij kishin probleme serioze dhe se miratimi i tyre do të sillte si pasojë cenimin e të drejtave kushtetuese e ligjore të shtetasve.

Përfitojmë nga rasti të kujtojmë se ndryshime të tilla në legjislacion, bëhen pas një planifikimi paraprak, gjë që nuk e kemi konstatuar në rastin e këtij ligji. Kështu përveç mungesës së një procesi të gjerë të konsultimit publik, nuk rezulton që një projektakt i tillë të kenë qenë parashikuar për miratim, në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve që miratohen konform detyrimit të parashikuar nga neni 27, i ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, apo edhe në paketa të tjera ligjore, që u ndërmoren si në kuadër të legjislacionit për reformën në drejtësi, por edhe më pas.

Institucioni ynë vazhdimisht ka theksuar se ndryshimet e shpeshta të legjislacionit të së njëjtës fushë, miratimi i ligjeve pa respektuar procedurat përkatëse, në mungesë harmonie me legjislacionin europian ku vendi ynë synon të bëhet pjesë, përveç problematikave të tjera, mund të përbëjnë premisa për cenimin e standardeve të të drejtave të njeriut.

Sikurse dihet, Kuvendi në datën 29.10.2020 miratoi ligjin nr. 133/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar.¹ Ligji ju përcoll Presidentit të Republikës për dekretim dhe shpallje, i cili në ushtrim të të drejtës së parashikuar në pikën 1 të nenit 85 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ja ka kthyer Kuvendit për rishqyrtim për arsye se shkel në mënyrë të drejtëpërdrejtë nenet 7, 17, 116 dhe 148 të Kushtetutës dhe nenin 8 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Ndërkohë Kuvendi me Vendimin nr. 73/2020 ka vendosur për rrëzimin e Dekretit nr. 11841, datë 20.11.2020, të Presidentit të Republikës “Për kthimin e ligjit nr. 133/2020, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar”.

Ky ligj është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 217 të vitit 2020 në datën 14.12.2020 dhe ka hyrë në fuqi, 15 ditë pas botimit.

Avokati i Popullit në cilësinë e organit kushtetues që ka si mision mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit, nga veprimet dhe mosveprimeve e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, konstaton dhe vlerëson se nenet 1 dhe 8 të ligjit nr. 133/2020 vijnë në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe me jurisprudencën e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe atë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, sepse:

1. Cenojnë rëndë parimet e rëndësishme, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të cilat qëndrojnë në themelet e shtetit të së drejtës të garantuara nga neni 15 (të drejtat dhe liritë themelore të individit), neni 36 (liria dhe fshehtësia e korrespondencës ose e çdo mjete tjetër të komunikimit), neni 37 (papakshmëria e banesës), neni 42 (e drejta për një proces të rregullt ligjor);

¹ Miratuar me datë 31.07.2014

2. Cenojnë të drejtën e privatësisë të garantuar nga neni 8 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut;

3. Krijojnë premisa që ta kthejnë Policinë e Shtetit në një organ që mbikëqyr e gjurmon qytetarët jashtë një procesi penal dhe kontrollit të organeve të prokurorisë dhe gjykatës;

4. Vijnë në kundërshtim me nenin 116 të Kushtetutës, i cili parashikon hierarkinë e akteve normative që kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë;

Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut ka parashikuar dhe garantuar një sërë të drejtash dhe lirish themelore të njeriut, ndër të cilat edhe ***E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare***².

Qëllimi kryesor i nenit 8 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut është mbrojtja nga ndërhyrjet arbitrare në jetën private dhe familjare, shtëpinë dhe korrespondencën dhe çdo mjeti tjetër të komunikimit nga një autoritet publik.³ Ky detyrim është i llojit klasik negativ, i përshkruar nga Gjykata si objekti thelbësor i nenit 8 të KEDNJ⁴. Megjithëse objekti i Nenit 8 është në thelb ai i mbrojtjes së individit nga ndërhyrjet arbitrare nga autoritetet publike, në veçanti, ai nuk e detyron thjesht Shtetin të abstenojë nga një ndërhyrje e tillë: përveç kësaj ndërmarrje kryesisht negative, mund të ketë detyrime pozitive të natyrshme në një respekt efektiv për jetën private⁵.

Garantimi i respektimit të jetës private dhe familjare të sanksionuar nga neni 8 i KEDNJ është implementuar në nenet 15, 17, 36, 37 dhe 42 të Kushtetutës tonë.

Në gjykimin e Avokatit të Popullit, ndryshimet e miratuara në ligjin e sipërcituar nuk e kalojnë testin e kushtetutshmërisë së normave dhe garancive të parashikuara tashmë në Kushtetutën tonë, si dhe më pas në KEDNJ. Në frymën e nenit 17 të Kushtetutes, duhet mbajtur parasysh fakti se kufizimet e të drejtave dhe lirive të parashikuara në Kushtetutë

² Titull i shtuar sipas dispozitave të Protokollit Nr 11 (ETS Nr 155).

³ Shih çështjen Libert kundër Francës, §§ 40-42, të GJEDNJ.

⁴ Kroon dhe të tjerët kundër Hollandës, § 31.

⁵ Lozovyye kundër Ruisë, § 36.

nuk mund të cenonë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalonë kufizimet e parashikuara në KEDNJ.

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut ka pohuar në mënyrë të përsëritur se çdo ndërhyrje nga një autoritet publik në të drejtën e një individi për të respektuar jetën private dhe korrespondencën duhet të jetë “*në përputhje me ligjin*”. Kjo shprehje jo vetëm që kërkon pajtueshmëri me ligjin e brendshëm, por gjithashtu lidhet me cilësinë e këtij ligji, duke kërkuar që ajo të jetë në përputhje me shtetin e së drejtës⁶.

Gjykata jonë Kushtetuese në vendimin 34 të vitit 2005 ka saktësuar se “ .. *Shteti i së drejtës, i cili garantohet në Preambulën e Kushtetutës, është një nga parimet themelore e më të rëndësishme në shtetin e shoqërinë demokratike. Si i tille ai përbën një normë të pavarur kushtetuese, prandaj shkelja e tij përbën në vetvete bazë të mjaftueshme për deklarimin e një ligji si antikushtetutes...* ”.

Në rastin konkret, vlerësojmë se jemi para një mundësie të pakufizuar të strukturave të Policisë së Shtetit për të kryer përgjime masive, pa kufij në subjekte dhe figura veprash penale, të pajustificuara ligjërish, si dhe pa një kontroll mbi ligjshmërinë e veprimeve të tyre nga ana e organeve të Prokurorisë dhe Gjykatave. Termi i parashikuar dhe i trajtuar më lart “*në përputhje me ligjin*” duhet të parashikojë jo vetëm mundësinë e realizimit të përgjimit nga struktura kompetente, por edhe faktin që procedurat që do të ndiqen, të ofrojnë dhe parashikojnë garancitë e procesit të rregullt ligjor, parashikuar edhe nga neni 42/2 i Kushtetutës tonë dhe neni 6/1 i KEDNJ-së, me qëllim që individi të ketë dhe të mund të shfrytëzojë të gjitha garancitë dhe mjetet juridike që parashikojnë instrumentat e sipërcituar.

Në një shoqëri demokratike brenda kuptimit të Konventës, e drejta për një ushtrim të drejtë të drejtësisë, zë një vend kaq të rëndësishëm sa një interpretim i kufizuar i Nenit 6 (1) nuk do t'i korrespondonte synimit dhe qëllimit të asaj dispozite⁷.

Vendimet e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut në interpretim dhe garantim të të drejtave dhe lirive themelore, përbëjnë standardin më të lartë, të cilit duhet t'i referohen Shtetet Palë në mbrojtjen e këtyre të drejtave për qytetarët e tyre, dhe nga ana tjetër

⁶ Halford v. The United Kingdom, § 49

⁷ Delcourt kundër Belgjikës, 17 Janar 1970, paragrafi 25.

shërbejnë jo vetëm për të vendosur mbi çështjet e parashtruara, por, në përgjithësi, për të sqaruar, mbrojtur dhe zhvilluar rregullat e parashikuara nga Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, duke kontribuar kështu në respektimin nga Shtetet të angazhimeve të ndërmarra prej tyre si Palë kontraktuese⁸.

Misioni i sistemit të vendosur nga Konventa është të përcaktojë çështjet e politikës publike në interes të përgjithshëm, duke ngritur kështu standardet e mbrojtjes të të drejtave të njeriut dhe duke shtrirë jurisprudencën e të drejtave të njeriut në të gjithë komunitetin e Shteteve të Konventës⁹. Gjykata, në praktikën e saj ka theksuar rolin e Konventës si një “*instrument kushtetues i rendit publik Evropian*” në fushën e të drejtave të njeriut¹⁰.

GJEDNJ ka arsyetuar gjithashtu se ligji kombëtar duhet të jetë i qartë, i parashikueshëm dhe i aksesueshëm në mënyrë të përshtatshme¹¹. Gjithashtu ligji kombëtar duhet të tregojë me një qartësi të arsyeshme fushën dhe mënyrën e ushtrimit të diskrecionit përkatës, me të cilin janë ngarkuar autoritetet publike, në mënyrë që t’u sigurojë individëve shkallën minimale të mbrojtjes, bazuar në parimin e shtetit të së drejtës dhe sundimit të ligjit në një shoqëri demokratike¹². Në këtë kuadër, gjykojmë gjithashtu se garancitë që u ofrohen individëve, duhet të jenë të parashikuara në ligj, pasi kufizojnë një të drejtë themelore të individit, dhe jo të bien në nivelin e akteve nënligjore, siç parashikohet në ndryshimet e reja, në bazë të të cilave parashikohet se rregullat do përcaktohen nga një strukturë e emërtuar si “*Komiteti Kombëtar i Politikave për Parandalimin dhe Luftën Kundër Krimin të Organizuar*”.

Nga përmbajtja e ligjit konstatojmë se shqetësimet dhe vërejtjet e bëra publike nga Avokati i Popullit, por edhe nga disa organizata të shoqërisë civile të cilat kanë si objekt të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e të drejtave të njeriut, nuk janë marrë në konsideratë si

⁸ Irlanda kundër Mbretërisë së Bashkuar, § 154, 18 Janar 1978, Seria A nr. 25, dhe, më vonë, Jeronovičs v. Latvia [GC], nr. 44898/10, § 109, ECHR 2016

⁹ Konstantin Markin k. Rusisë [GC], § 89, nr. 30078/06, GJEDNJ 2012.

¹⁰ Bosphorus Hava Yolları Turizm ve Ticaret Anonim Şirketi kundër Irlandës [GC], nr. 45036/98, § 156, KEDNJ 2005VI.

¹¹ Silver dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar, § 87

¹² Piechowicz k. Polonisë, 212 §.

nga komisionet e Kuvendit, ashtu edhe nga vetë ky i fundit gjatë procesit të shqyrtimit dhe miratimit të ligjit në fjalë.

Lidhur me konstatimet e renditura më sipër po parashtrojmë argumentet si më poshtë:

Së pari, ligji nr. 133/2020, me parashikimin e bërë në nenet 1 dhe 8 të tij, e shndërron Policinë e Shtetit në një organ informativo-gjurmues, jashtë kontrollit procedural të gjykatës dhe në kundërshtim me misionin e saj ligjor të përcaktuar në nenin 2¹³ të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar. Kjo dispozitë ligjore krijon premisa serioze për shkeljen e të drejtave dhe lirive të qytetarëve, të cilët mund të mbikëqyren e gjurmohen pa asnjë lloj kufizimi. Termi “*veprimtari informative-gjurmuese*” është i paqartë, ul garancitë për mbrojtjen e individit, si dhe mund të çojë në subjektivitet dhe abuzivizëm të strukturave duke mbikëqyrur dhe monitoruar pa kriter dhe pa iu nënshtruar verifikimit ligjor nga strukturat e parashikuara në Kodin e Procedurës Penale, pra duke kufizuar të drejtën e individëve të mbrojtur dhe garantuar nga disa dispozita të Kushtetutës dhe neni 8 i KEDNJ. Siç e theksuam edhe më sipër, kufizimi i të drejtave themelore duhet të jetë i qartë, i parashikuar në ligj dhe proporcional me qëllimin që kërkohet të arrihet.

Kushtet mbi të cilat një shtet mund të ndërhyjë në gëzimin e një të drejte të mbrojtur përcaktohen në paragrafin 2 të Nenit 8 të Konventës, përkatësisht në interes të sigurisë kombëtare, sigurisë publike ose mirëqenies ekonomike të vendit, për parandalimin e trazirave ose krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve. Kufizimet lejohen nëse ato janë “*në përputhje me ligjin*” ose “*të përcaktuara me ligj*” dhe janë “*të nevojshme në një shoqëri demokratike*” për mbrojtjen e një prej objektivave të përcaktuara më sipër.

¹³ Në nenin 2 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, përcaktohet se: “*Policia e Shtetit ka për mision ruajtjen e rendit e të sigurisë publike, ruajtjen e personaliteteve të larta shtetërore dhe objekteve të rëndësishme të veçantë, garantimin e zbatimit të ligjit, në përputhje me Kushtetutën dhe aktet ndërkombëtare, duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut.*”

1. Neni 1 i ligjit nr. 133/2020, parashikon një shtesë në dispozitën e nenit 6, duke parashikuar se:

“1. Në nenin 6 pas pikës 29 shtohet pika 29/1 me këtë përmbajtje:

“29/1. “Veprimtari informative” është çdo veprim apo masë e Policisë së Shtetit, përfshirë informacionet e marra nga përdorimi i teknikave të gjurmimit apo mbikëqyrjes së veçantë të komunikimeve joelektronike, dokumentimin e tyre sipas legjislacionit në fuqi, në kuadër të parandalimit të kryerjes së veprave penale, hetimit penal apo ruajtjes së rendit e të sigurisë publike.”.

2. Neni 8 i ligjit nr. 133/2020, ndryshon tërësisht nenin 131, të ligjit ekzistues nr. 108/2014, me këtë përmbajtje të re:

“Neni 131

Masa të veçanta

“1. Gjatë veprimtarisë informative-gjurmuese, me qëllim parandalimin e veprave penale, zbulimin e veprave penale, identifikimin apo lokalizimin e autorëve të tyre, Policia e Shtetit merr, grumbullon, përpunon dhe dokumenton informacion dhe të dhëna nëpërmjet:

a) mbikëqyrjes së veçantë zanore të komunikimeve joelektronike të personave të dyshuar në ambiente publike apo të hapura për publikun me autorizim të prokurorit;

b) mbikëqyrjes së veçantë vizuale të personave të dyshuar në vende publike apo të hapura për publikun;

c) gjurmimit ose mbikëqyrjes së veçantë të personave të dyshuar nëpërmjet përdorimit të mjeteve, pajisjeve apo teknikave të veçanta për identifikimin ose lokalizimin e vendndodhjes së tyre.

2. Kushtet, rregullat, procedurat dhe afatet që zbatohen për përdorimin e masave të veçanta të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, të Prokurorit të Përgjithshëm dhe të drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

3. Ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, Prokurori i Përgjithshëm dhe drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar mund të kontrollojnë në çdo kohë zbatimin e rregullave dhe procedurave të parashikuara në udhëzimin e përbashkët të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni.”.

Konstatohet se riformulimi dhe përmbajtja e nenit të ri, ka sjellë dy ndryshime thelbësore që afektojnë të drejtat e njeriut në ligjin organik të Policisë së Shtetit dhe konkretisht:

1. Policisë së Shtetit i jepet me ligj e drejta që gjatë veprimtarisë informative-gjurmuese me qëllim *parandalimin e veprave penale, zbulimin e veprave penale, identifikimin apo lokalizimin e autorëve të tyre, të grumbullojë, përpunojë dhe dokumentojë informacion dhe të dhëna nëpërmjet përdorimit të disa masave të veçanta si:*

a) *mbikëqyrjes së veçantë zanore të komunikimeve joelektronike të personave të dyshuar në ambiente publike apo të hapura për publikun me autorizim të prokurorit;*

b) *mbikëqyrjes së veçantë vizuale të personave të dyshuar në vende publike apo të hapura për publikun;*

c) *gjurmimit ose mbikëqyrjes së veçantë të personave të dyshuar nëpërmjet përdorimit të mjeteve, pajisjeve apo teknikave të veçanta për identifikimin ose lokalizimin e vendndodhjes së tyre.*

Së dyti, heq detyrimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për të asgjësuar të gjithë informacionin e mbledhur si rezultat i përdorimit të këtyre masave, në rastet kur referimi i veprës penale, për të cilën janë përdorur masat e veçanta, nuk bëhet brenda gjastë muajve pas përfundimit të përdorimit të tyre.

Vlerësojmë se masat e veçanta të parashikuara në këtë dispozitë “Gjurmimi” dhe “mbikëqyrja e veçantë” për nga mënyra e metoda e kryerjes së tyre, pajisjet, mjetet e teknikat e përdorura, si dhe të dhënat dhe informacioni i grumbulluar për personat e dyshuar si autorë të një veprimtarie kriminale janë veprime apo forma të caktuara pune të ngjashme me “përgjimin”. Madje qartësisht termat: “gjurmim”, “mbikëqyrje e veçantë”, apo edhe “përgjim”, janë sinonime të njërit-tjetrit në përkufizimet e tyre të dhëna si në fjalorin e gjuhës shqipe, ashtu edhe në përkufizimet e bëra në legjislacionin procedural penal. Përdorimi i termave thelbësisht të njëjtë, pa ndryshim në qëllimin për të cilin kryhet veprimi, apo se çfarë veprimesh përmbledh në vetvete, nuk mund të bishtojnë në mënyre legjitime parashkimet apo kufizimet procedurale, të cilat janë vënë si masa paraprake, për të parandaluar apo mos lejuar, abuzimin me to. Në të kundërt të tilla parashikime mund të përbëjnë premise për përdorim jashtë qëllimit për të cilin janë dhënë. Për këto arsye është e domosdoshme që këto masa të veçanta të aplikohen me

autorizim të autoritetit gjyqësor dhe në raste emergjente të organit të ndjekjes penale, prokurorisë, pasi kjo mënyrë të vepruari është një garanci për zbatimin e ligjit me korrektësi dhe për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të shtetasve.

Kujtojmë se kjo veprimtari policore, në ligjin e mëparshëm ka qenë e rregulluar në këtë mënyrë dhe për kryerjen e këtyre veprimeve Policia e Shtetit kërkonte autorizimin e prokurorit. Konkretisht, në ligjin nr. 108/2014, neni 131 (i ndryshuar me nenin 8 të ligjit nr. 133/2020) parashikonte që çdo lloj veprimtarie: përgjimi, mbikëqyrëse dhe gjurmuese, të kryhej në përputhje me parashikimet e ligjit procedural penal.

Ndërkohë edhe Kodi i Procedurës Penale, në Seksionin IV, përcakton se përgjimi i komunikimeve të një personi ose të një numri telefoni, me telefon, faks, kompjuter, ose me mjete të tjera të çdo lloji, përgjimi i fshehtë me mjete teknike i bisedave në vende private, përgjimi me audio dhe video në vende private dhe regjistrimi i numrave të telefonit, hyrës dhe dalës, lejohen vetëm me kërkesë të prokurorit, *kur e autorizon gjykata* (nenet 221 dhe 222 të Kodit të Procedurës Penale).

Ky rregullim është bërë nga ligjvënësi sepse përgjatë kësaj veprimtarie policore krijohen, ruhen, administrohen edhe të dhëna të ndjeshme, jo vetëm për personat ndaj të cilëve ato aplikohen, por edhe ndaj personave të tjerë të rrethit familjar, shoqëror, miqësor të tyre, apo të personave të rastësishëm në ambientet publike, apo të hapura për publikun, të mbikëqyrura dhe gjurmuara. Për këto arsye veprimi policor pa kontroll, do të krijonte hapësira për abuzim me këtë kompetencë, dhe mundësi reale, që të dhënat e administruara mund të shpërndahen ose keqpërdoren, për qëllime të ndryshme, jo të ligjshme ndaj personave të caktuar, si mjet presioni, kompromentimi, shantazhi, etj.

Theksojmë se dhënia e kësaj kompetence Policisë së Shtetit (pa parashikuar me ligj kufizime) vjen në kundërshtim të plotë dhe të hapur me Kodin e Procedurës Penale, kapitullin mbi “*përgjimet*”, nenet 221 deri 226, sipas të cilit organi kompetent dhe i vetëm për lejimin e përgjimit është gjykata. Ndërsa si rast përjashtimor këtë të drejtë e ushtron prokurori me akt të motivuar, por pas këtij veprimi, ai ka detyrimin që të njoftojë gjykatën menjëherë, por jo më vonë se njëzet e katër orë nga marrja e vendimit të tij. Kur vleftësimi

nuk bëhet në afatin e caktuar, përgjimi nuk mund të vazhdojë dhe rezultatet e tij nuk mund të përdoren.

Në rastin konkret duhet bërë dallimi, vlerësimi dhe respektimi i hierarkisë së akteve, pasi në vlerësimin tonë ka një përplasje dhe mbivendosje të dispozitave procedurale penale, të parashikuara nga Kodi i Procedurës Penale dhe që rregullon raportin dhe marrëdhënien mes strukturave të Policisë dhe kontrollit që ushtron Prokuroria dhe Gjykata, si edhe procedurave të përgjimit që organizon dhe zbaton sipas rastit struktura e Policisë.

Në çështjen të mëparshme,¹⁴ Gjykata ka nënvizuar dallimin që ekziston midis ligjeve organike, që miratohen me shumicë të cilësuar, dhe ligjeve të zakonshme që miratohen me shumicë të thjeshtë. Nga pikëpamja e burimeve të së drejtës ligjet organike ose të cilësuar, qëndrojnë më lart se ligjet e zakonshme, të cilat në vetvete nuk mund të trajtojnë çështje që janë parashikuar të trajtohen nga kodet apo ligjet organike. Ideja që një kategori ligjesh, për shkak të rëndësisë të tyre, të miratoheshin nga Kuvendi me shumicë të cilësuar, u zbatua së pari, për t'i bërë ato sa më të qëndrueshme dhe, së dyti, për të shmangur mundësinë që forca politike, që do të kishte shumicën, të cenonte parime themelore për funksionimin e një shoqërie demokratike.¹⁵

Një parashikim i tillë në ndryshimet aktuale në ligjin “*Për Policinë e Shtetit*”, mund të konfundojë/konfuzojë edhe vetë strukturat e Policisë në ndjekjen dhe vijimin e procedurave të qarta, sakta, rigoroze dhe standarde në përmbushjen e detyrave të tyre funksionale, pikërisht për shkak të dublimit dhe parashikimeve të dyfishta të procedurave dhe mënyrave të përgjimit në kod dhe ligj.

Gjykata ka theksuar se në hierarkinë e akteve, ligjet e përforcuara renditen para ligjeve të zakonshme të Kuvendit.¹⁶ Në nenin 4/2 të Kushtetutës deklarohet se: “*Kushtetuta është ligji më i lartë në Republikën e Shqipërisë*”. Deklarimi i epërsisë së Kushtetutës, duke e vendosur në majë të piramidës së normave juridike, është një aspekt thelbësor i parimit

¹⁴ Shih vendimin nr. 1, datë 12.01.2011 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

¹⁵ Shih “Debati Kushtetues 1” fq. 298 e në vijim.

¹⁶ Shih vendimet nr.9, datë 23.03.2010 dhe nr.19, datë 03.05.2007, të Gjykatës Kushtetuese.

të shtetit të së drejtës. Aktet juridike, që nxirren nga organet shtetërore, duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta, si në kuptimin formal, ashtu edhe atë material.¹⁷

Gjithashtu është e rëndësishme të evidentojmë faktin se në Kodin e Procedurës Penale parashikohen edhe kufijtë e përgjimit, i cili nuk mund të bëhet për gjitha llojet e veprave penale, sikurse i jepet kompetencë Policisë së Shtetit me ligjin nr. 133/2020.

Në paragrafin 2, të nenit 221 të Kodit të Procedurës Penale është parashikuar se regjistrimi i fshehtë fotografik, filmik ose me video i personave në vende publike dhe përdorimi i pajisjeve gjurmuese të vendndodhjes lejohen vetëm kur procedohet për vepra të kryera me dashje, për të cilat parashikohet dënim me burgim jo më pak, në maksimum, se tre vjet.

Ndërsa neni 222, pika 6, sanksionon se ky veprim procedural kryhet me *vendim gjykate për të realizuar përgjimin e fshehtë, fotografik ose me video, ose përgjimin e bisedave në vende private.*

Në kundërshtim me përcaktimet e Kodit të Procedurës Penale, ligji nr. 133/2020, me parashikimet e bëra në nenin 131 të ndryshuar, tashmë i lejon Policisë së Shtetit si mbikëqyrjen e veçantë vizuale (ku mund të përfshihet sipas rastit edhe përgjimi/mbikëqyrja fotografike ose me video), edhe gjurmimin dhe mbikëqyrjen e veçantë përmes mjeteve, pajisjeve apo teknikave të veçanta për identifikimin ose lokalizimin e vendndodhjes së personave të dyshuar për kryerjen e një veprave penale. Pra, jo sipas kërkesave të Kodit të Procedurës Penale, pa vendim gjykate dhe pa veprime paraprake të prokurorit. Duke iu referuar nenit 287 të këtij Kodi,¹⁸ minimalisht duhet të jetë bërë regjistrimi i emrit të personit që i atribuohet vepra penale në regjistrin e organit të prokurorisë dhe vetëm pas kësaj prokurori autorizon kryerjen e veprimeve hetimore,

¹⁷ Shih vendimet: nr.19, datë 03.05.2007; nr.3, datë 20.02.2006; nr.29, datë 09.11.2005, të Gjykatës Kushtetuese.

¹⁸ Në nenin 287 të Kodit të Procedurës Penale, “Regjistrimi i njoftimit të veprave penale” parashikohet se:
1. Prokurori shënon në regjistër çdo njoftim të veprës penale që i vjen ose që ka marrë me iniciativën e vet dhe në të njëjtën kohë ose nga momenti në të cilin rezulton, emrin e personit të cilit i atribuohet vepra penale.

2. Ndalohet publikimi i regjistrimeve të bëra deri në marrjen si të pandehur të personit që i atribuohet vepra penale.

sikurse janë edhe ato të përgjimit, regjistrimit të fshehtë fotografik, filmik ose me video, i personave në vende publike dhe përdorimit të pajisjeve gjurmuese të vendndodhjes. Këtë veprim sipas riformulimit të nenit 131, Policia e Shtetit do ta bëjë jashtë një procedimi penal dhe duke e kamufluar me emërtimet e reja të “*mbikëqyrjes së veçantë zanore të komunikimeve joelektronike, mbikëqyrjes së veçantë vizuale apo të gjurmimit*”, duke shkelur në këtë mënyrë, privatësinë jo vetëm të personave të dyshuar, por edhe të personave të tjerë, si në ambient të hapura, ashtu edhe të mbyllura, pasi nuk e përjashton shprehimisht këtë të fundit.

Vlerësojmë se çdo lloj veprimtarie që nuk kalon në kontrollin *ex ante* dhe *ex post* të prokurorit apo gjykatës, bie ndesh me vetë dispozitat e ligjit që u ndryshua, i cili në nenin 17, pika 1, shkronja “c”, përcakton në mënyrë të qartë se, detyrat e Policisë së Shtetit janë:

“c) parandalon, zbulon dhe heton, në përputhje me legjislacionin penal dhe procedural penal, veprat penale dhe autorët e dyshuar të kryerjes së tyre.

Sa më sipër, rezulton e qartë se duke bërë një parashikim të tillë brenda të njëjtit ligj, përcaktohen rregulla të posaçme procedurale, të ndryshme nga ato të Kodit të Procedurës Penale, që nuk ofrojnë të njëjtat garanci për qytetarët, si garancitë e parashikuara nga legjislacioni procedural penal.

Nga ana tjetër, Avokati i Popullit vlerëson se cenimi i parimit të arsyetimit të vendimit të kryerjes së përgjimit, përben një nga shkeljet e tjera që janë parashikuar në garancitë e kuadrit ligjor në fuqi përsa i përket mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të individit. Arsyetimi i vendimit përben një nga bazat e fillimit të procedurave respektive dhe shmangia e këtij detyrimi përben shkak për cënim të parimeve themelore të së drejtës. Ndryshimet e kundërshtuara nuk u nënshtrohen kontrollit *ex ante* apo *ex post* duke i mohuar këtij procesi një vendimarrje të arsyetuar për verifikimin e shkakut legjitim, siç parashikohet nga neni 17 i Kushtetutës për të cenuar liritë thelemore. Kjo pasi arsyetimi i vendimit gjyqësor është detyrim kushtetues, i përcaktuar qartë në nenin 142, pika (1) të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin parashikohet se: “*Vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara*”. Ky detyrim kushtetues përben një garanci për zhvillimin e

procesit të rregullt ligjor nga ana e gjykatave. Arsyetimi i vendimit është një garanci kushtetuese, që çështja është shqyrtuar me hollësi dhe përgjegjshmëri nga ana e strukturave që e kanë marrë atë vendim të bazuar në ligj, pas një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm. Arsyetimi i vendimit është një kusht i domosdoshëm edhe për shqyrtimin që do t'i bëjnë çështjes gjykatat më të larta. Mungesa e arsyesimit të vendimit jo vetëm e bën atë të pavlefshëm, por çon edhe në konkluzionin se autoriteti vendimmarrës, nuk ka kryer një analizë tërësore dhe objektive të provave të administruara në dosje. Si të mos mjaftonte kjo, nga leximi i ligjit rezulton se edhe standarti i arsyesimit të vendimarrjes brenda strukturave të policisë së shtetit nuk garantohet nga këto ndryshime. Në se më parë (apo në Kodin e Procedurave Penale) përgjimi përjashtimisht mund të kryhet vetëm mbi bazën e një vendimi të arsyesuar të prokurorit, i cili do duhet të marrë në çdo rast miratimin posterior të gjykatës, tashmë gjurmimi, në disa raste kryhet pa pasur as detyrim për të arsyesuar në nivelin e strukturave të policisë së shtetit vendimarrjen për gjurmimin.

Ndërsa standarti i procesit të rregullt ligjor është duke u evoluar e rritur, duke u bërë pjesë e procedurave hetimore dhe administrative dhe përmbajtjes së vendimarrjes (mungesa e arsyesimit në vendimet gjyqësore), këto ndryshime paraqesin një standard thelbësisht më të ulët në mbrojtje të të drejtave të njeriut.

Gjithashtu konstatojmë se në këtë dispozitë nuk është parashikuar kohëzgjatja, afati i zbatimit të këtyre masave të veçanta (*mbikëqyrjes së veçantë zanore të komunikimeve joelektronike të personave të dyshuar, mbikëqyrjes së veçantë vizuale, gjurmimit dhe mbikëqyrjes së veçantë të personave të dyshuar nëpërmjet përdorimit të mjeteve, pajisjeve apo teknikave të veçanta për identifikimin ose lokalizimin e vendndodhjes së tyre*), por është parashikuar që të rregullohet me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, të Prokurorit të Përgjithshëm dhe të drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Ndërkohë që në nenin 131/2¹⁹ të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, ishte i parashikuar afati i përgjimit, duke iu referuar legjislacionit përkatës, që nënkupton Kodin e Procedurës Penale, i cili në nenin 222/5 parashikon se *vendimi i gjykatës për përgjimin tregon mënyrën e kryerjes dhe kohëzgjatjen e veprimeve, e cila nuk mund t'i kalojë 15 ditë. Ky afat me kërkesë të arsyetuar të prokurorit, mund të zgjatet nga gjykata sa herë është e nevojshme, për një periudhë prej 15 ditësh, kur ekzistojnë kushtet e parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni dhe rezultatet e përgjimit diktojnë nevojën e zgjatjes së afatit.*

Pra, përderisa afati i përgjimit është parashikuar në Kodin e Procedurës Penale në fuqi, nuk ka asnjë arsye që me ligjin objekt i kësaj kërkesë, të nxirret e miratohet një akt nënligjor, qoftë ai edhe udhëzim i përbashkët i ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, Prokurorit të Përgjithshëm dhe të drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Heqja e detyrimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për të asgjësuar gjithë informacionin e mbledhur si rezultat i përdorimit të këtyre masave, në rastet kur referimi i veprës penale, për të cilën janë përdorur masat e veçanta, nuk bëhet brenda gjashtë muajve pas përfundimit të përdorimit të tyre, është në dëm të të drejtave të shtetasve të përgjuar, mbikëqyrur dhe gjurmuar sepse atyre iu hiqet një garanci ligjore e cila ishte parashikuar në nenin 131/3²⁰ të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar.

Në nenin 131 të riformuluar të ligjit nr. 133/2020 nuk parashikohet as e drejta e ankimit ndaj vendimit të strukturave të Policisë së Shtetit që vendosin për zbatimin e masave të veçanta, nga i interesuari që ka ardhur në dijeni të këtyre masave, i cili është një mjet mbrojtës i të drejtave të shtetasve.

¹⁹ 2. Përdorimi i masave të veçanta, sipas pikës 1, të këtij neni, lejohet për aq kohë sa ekzistojnë arsyet ose rrethanat që kanë bërë të nevojshëm autorizimin e tyre për përdorim veçmas ose të kombinuar dhe zgjat sipas afateve të vendosura në legjislacionin përkatës.

²⁰ 3. Kur referimi i veprës penale, për të cilën janë përdorur masat e veçanta, nuk bëhet brenda gjashtë muajve pas përfundimit të përdorimit të masave të veçanta, të parashikuara në këtë nen, i gjithë informacioni i mbledhur si rezultat i përdorimit të këtyre masave asgjësohet, sipas rregullave të përcaktuara nga Drejtori i Policisë së Shtetit.

Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar në vijimësi se e drejta për t'iu drejtuar gjykatës, ndër të tjera, ka për qëllim të garantojë shtetasit nga çdo veprim që u shkakton cenim të të drejtave të tyre, pa përjashtuar rastet kur cenimi vjen nga ndonjë akt i administratës shtetërore. Shteti i së drejtës presupozon që çdo ndërhyrje e autoriteteve ekzekutive në të drejtat e individit apo të personave juridikë duhet të jetë objekt i një kontrolli efektiv nga një organ që ofron garantimin e pavarësisë dhe paanësisë gjatë procesit të shqyrtimit të procesit.²¹

E drejta e ankimit gjyqësor ndaj vendimeve të një organi administrativ, duke parashikuar mjetin dhe afatin e ankimit plotëson standardin kushtetues të së drejtës së ankimit. Për rrjedhojë, Gjykata ka çmuar se parashikimi ligjor është i domosdoshëm për të realizuar të drejtën e ankimit gjyqësor ndaj akteve administrative që nxjerr organi administrative.

Theksojmë se parashikimi i garancive ligjore, si kontrolli gjyqësor para zbatimit të masave të veçanta, kohëzgjatja e aplikimit të tyre, e drejta e ankimit në gjykatë ndaj vendosjes së këtyre masave, detyrimi i organeve që kanë administruar të dhënat e grumbulluara nga aplikimi i tyre pas kalimit të një afati të caktuar, etj., janë të domosdoshme për të parandaluar arbitraritetin që, sikurse rezulton nga praktika e deritanishme botërore, është i mundshëm nga strukturat shtetërore që kryejnë veprime sekrete si përgjimi, gjurmimi dhe mbikëqyrja e veçantë. Ne vlerësojmë se heqja e këtyre garancive ligjore në ligjin objekt të kësaj kërkese, sjell në mënyrë të drejtëpërdrejtë cenimin e thelbit të të drejtave kushtetuese të individit dhe tejkalimin e kufizimeve të parashikuara në KEDNJ.

Sjellim në vëmendje se për të bërë të mundur parandalimin e veprave penale të rënda nga strukturat e Policisë së Shtetit nëpërmjet përgjimit parandalues, është aktualisht në fuqi një ligj i veçantë nr. 9157, datë 04.12.2003 “*Për përgjimin e komunikimeve elektronike*”, të ndryshuar. Sipas këtij ligji, përgjimi parandalues bëhet me autorizim të Prokurorit të Përgjithshëm, por rezultatet e tij nuk mund të përdoren si provë. Sipas dispozitave të këtij

²¹ Shih vendimin nr.10, datë 29.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese.

ligji, qëllimi i tij është të rrisë efektivitetin e punës së institucioneve shtetërore informative për zbulimin e veprimtarisë antikushtetuese, kriminale dhe keqbërëse, si dhe të parandalojë pasojat që mund të vijnë nga kjo veprimtari. Një nga organet e parashikuara në nenin 6 të tij, që mund të kërkojnë kryerjen e përgjimit, është edhe shërbimi informativ/polikor i Ministrisë së Brendshme (*Policia Kriminale e Policisë së Shtetit*), për të siguruar të dhënat e domosdoshme për realizimin e detyrave të tyre ligjore. Pra, deri sa aktualisht ka një ligj në fuqi, që i jep të drejtën Policisë së Shtetit, t'i kërkojë Prokurorit të Përgjithshëm përgjimin e autorëve të dyshuar, për të bërë të mundur parandalimin e veprimtarisë kriminale, nuk është i nevojshëm ndryshimi i bërë në nenin 131 të ligjit organik nr. 108/2014 me ligjin nr. 133/2020. Gjithsesi, duhet theksuar fakti se garancitë e parashikuara për mbrojtjen e të drejtave të individit në atë procedurë, janë garancitë minimale që duhet të ruhen edhe në rastin e ndërmarrjes së procedurave të mbikëqyrjes ambientale, nga struktura të policisë për individë të caktuar, por që mund të kthehen në fakt në mbikëqyrje masive të një grupi të gjerë e të papërcaktuar individësh, përtej rrethit të objektit të përcaktuar për mbikëqyrje.

Për sa më sipër, vlerësojmë se miratimi dhe zbatimi i këtij neni krijon premisa për shkeljen e të drejtave kushtetuese e ligjore të shtetasve dhe kryesisht asaj të privatësisë nga strukturat e Policisë së Shtetit dhe ardhjen e pasojave të mëdha, serioze dhe të pariparueshme, në jetën e personave ndaj të cilëve aplikohen masat e veçanta, personave të tjerë me të cilët këta të fundit kanë komunikuar, janë shoqëruar apo kanë qënë të pranishëm në mënyrë rastësore në vendet e ambientet publike, apo të hapura për publikun, të mbikëqyrura apo gjurmua nga strukturat e Policisë së Shtetit, si dhe të familjeve dhe rrethit shoqëror të tyre.

Në këtë kuadër, Avokati i Popullit gjykon dhe vlerëson se së pari, kjo është mohim i garancive minimale të pranuar se ndryshimet e ndërmarra në ligjin objekt kërkesë, plotësojnë parashikimin e Kushtetutës për privatësinë nga njëra anë, por ndërkohë lejojnë shkeljen e të drejtave kushtetuese nga ana tjetër, për të gjithë individët, të cilët direkt apo indirekt i nënshtrohen këtyre procedurave të strukturave të policisë, pa një akt konkret që përmban të gjithë elementët ligjorë, si edhe jashtë kontrollit dhe autorizimit respektiv që

ushtrohet nga Prokuroria apo Gjykata, në kuadër të garancive që ofron dhe parashikon legjislacioni procedural penal në fuqi.

Kjo bëhet edhe më shqetësuese, kur ende sot nuk kemi një përcaktim të saktë e të qartë ligjor dhe shterues të përkufizimit të termave “*ambient publik*” dhe “*ambient të hapur për publikun*”.

Aplikimi i masave të veçanta të gjurmimit dhe mbikëqyrjes së veçantë vizuale të jetës private të shtetasve nga Policia e Shtetit nëpërmjet ndryshimeve në ligjin organik të Policisë së Shtetit, jashtë rregullave procedurale penale dhe në kundërshtim me to, sjellë si pasojë cenimin e rëndë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të mbrojtura nga Kushtetuta dhe KEDNJ.

Neni 8 i ligjit nr. 133/2020 i cili ka ndryshuar nenin 131 të ligjit nr. 108/2014, të ndryshuar, vjen në kundërshtim me:

a) Nenin 17 të Kushtetutës, që sanksionon se, *kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.*

b) Nenin 8 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, “E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare”, që sanksionon se:

“1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij.

2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.”

Theksojmë se, ndonëse kufizimi (cenimi) i të drejtës së privatësisë së shtetasve është bërë me ligj, nuk rezulton që ai të jetë bërë *për një interes publik, ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Ndërkohë që kufizimi nuk është në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.* Gjithashtu vlerësojmë se ky ndryshim ligjor ka cënuar thelbin e lirive dhe të të drejtave kushtetuese dhe ka tejkalluar kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut, respektivisht nenin 8, për respektimin e jetës private.

Në mënyrë që të përcaktohet në se në një shoqëri demokratike, është e nevojshme ndërhyrja nga autoritetet, në jetën private, ose korrespondencën e aplikantëve, si edhe faktin në se vendoset një ekuilibër i drejtë midis interesave të ndryshëm të përfshirë në këtë proces, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka shqyrtuar çështje të shumta ku ka interpretuar dhe verifikuar në se ndërhyrja e autoriteteve në rastet përkatëse, ka qenë ose jo në përputhje me ligjin, ndiqte një qëllim ose synime të ligjshëm, apo ishte proporcional me qëllimin e ndjekur.

Neni 8 i Konventës është neni i përpunuar në termat më të gjerë ndërmjet të gjitha neneve të Konventës. Parimi nga ku, ky nen nisët, është ai që një individ ka të drejtë të jetojë i lirë nga shqetësimet e shtetit; pra që privati (individi) është në një pozitë më të lartë sesa shteti në lidhje me gëzimin e kësaj të drejte. Megjithatë, kur mirëqenia publike parashikon kufizime ndaj jetës private të individëve, duhet që këto kufizime të përcaktohen në mënyrë të qartë, të jenë logjikisht të justifikueshme, si dhe të përbëjnë minimumin e nevojshëm për të arritur objektivin e ligjshëm të përbashkët. Në rastet kur shteti ndërhyr në jetën private ose familjare të një personi, në banesën ose në korrespondencën e tij, ai duhet ta justifikojë këtë veprim bazuar në një prej kritereve të parashikuara në nenin 8 § 2 të Konventës.

Analiza e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut ka konsideruar faktin se sa herë u jepet autoriteteve kombëtare diskrecioni për të ndërhyrë në gëzimin e një të drejte të Konventës, garancitë procedurale në dispozicion të individit do të jenë veçanërisht të karakterit material, për të përcaktuar në se shteti i paditur, kur e parashikon kuadri rregullator, ka qëndruar brenda kufirit të tij të vlerësimit, për të ndërhyrë në atë të drejtë

të individit. Në të vërtetë është një praktikë gjyqësore e vendosur që procesi i vendimmarrjes që çon në masa të ndërhyrjes, duhet të jetë i drejtë dhe i tillë që të sigurojë respektimin e duhur të interesave të mbrojtura nga individit, nga neni 8 i KEDNJ-së²².

Për vendosjen e kufizimeve, nuk është e lejuar asnjë arsye tjetër, me përjashtimin e vetëm të nenit 17 të KEDNJ²³, i cili parashikon që një person nuk mund të pretendojë gëzimin e një të drejte, përmbushja e të cilës synon cënimin e të drejtave që një personi tjetër i parashikohen dhe garantohen nga ana e Konventës. Një nga karakteristikat më të spikatura të dispozitës së nenit 8 është ajo që në lidhje me shumë nga të drejtat që ajo parashikon, qëndrimi i shoqërisë dhe i publikut ndryshon në mënyrë të vazhdueshme.

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut ka trajtuar dhe parashikuar parimet dhe kriteret e ndërhyrjes së shtetit gjatë aplikimit të procedurave për përgjimin e personave të ndryshëm. Këto parime dhe standarde të shtjelluara në mënyrë të hollësishme konkretisht në disa çështje që po pasqyrojmë më poshtë, duhet të jenë synimi dhe qëllimi parësor i legjislatorit dhe agjencive të zbatimit të ligjit për respektimin e parimit të shtetit të së drejtës dhe garantimit e mbrojtjes të të drejtave të njeriut.

Gjykata ka pohuar në mënyrë të përsëritur se çdo ndërhyrje nga një autoritet publik në të drejtën e një individit për të respektuar jetën private dhe korrespondencën duhet të jetë “*në përputhje me ligjin*”. Kjo shprehje nënkupton që ndërhyrja jo vetëm që duhet të jetë në pajtueshmëri me ligjin e brendshëm, por gjithashtu lidhet me cilësinë e këtij ligji, duke kërkuar që ajo të jetë në përputhje me shtetin e së drejtës²⁴.

²² Buckley kundër Mbretërisë së Bashkuar, 76 §; Tanda-Muzinga kundër Frances, 68 §; M.S. kundër Ukrainës, 70 §.

²³ Neni 17 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut parashikon shprehimisht se: “*Asnjë nga dispozitat e kësaj Konvente nuk mund të interpretohet se i jep një Shteti, grupimi ose individit, të drejtën që të përfshihet në ndonjë veprimtari ose të kryejë ndonjë akt që synon cënimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në këtë Konventë ose kufizime më të gjera të këtyre të drejtave ose lirive sesa është parashikuar në Konventë.*”

²⁴ Halford v. The United Kingdom, § 49.

Në kontekstin e mbikëqyrjes, Gjykata Europiane ka interpretuar se ligji duhet të jetë mjaft i qartë në termat e tij për t'u dhënë qytetarëve një tregues të përshtatshëm të kushteve dhe rrethanave në të cilat autoritetet janë të autorizuar të përdorin çdo masë të mbikëqyrjes sekrete dhe mbledhjes së të dhënave²⁵. Në çështjen *Vukota-Bojiç kundër Zvicrës*, Gjykata ka gjetur shkelje të nenit 8 për shkak të mungesës së qartësisë dhe saktësisë në dispozitat e brendshme ligjore që kishin shërbyer si bazë ligjore e mbikëqyrjes së ankueses nga kompania e saj e sigurimeve pas një aksidenti. Në gjykimin dhe vlerësimin e Avokatit të Popullit, pikërisht kjo qartësi dhe saktësi e cunguar apo e munguar e dispozitave ligjore të parashikuara në ndryshimet e ligjit “*Për Policinë e Shtetit*”, shërben si bazë dhe indicie për shqyrtimin e kushtetutshmërisë së tyre, për cenimin flagrant të të drejtave të njeriut, të mbrojtura dhe garantuara nga Kushtetuta jonë dhe Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut.

Ligjshmëria gjithashtu kërkon që të ketë masa mbrojtëse të përshtatshme për të siguruar që të respektohen të drejtat e një individi të parashikuara nga neni 8 i KEDNJ-së. Përgjegjësia e një Shteti për të mbrojtur jetën private dhe familjare shpesh përfshin detyrime pozitive që sigurojnë respektimin e duhur të të drejtave të Nenit 8 në nivelin kombëtar. Kështu, Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut, e ka gjetur shkelje të së drejtës për jetën private mungesën e dispozitave të qarta ligjore që penalizojnë aktin e filmimit të fshehtë të një fëmije të zhveshur²⁶.

Një konstatim se masa në fjalë nuk ishte “*në përputhje me ligjin*” mjafton që Gjykata të vendosë se ka pasur një shkelje të Nenit 8 të Konventës. Ndaj nuk është e nevojshme të shqyrtohet nëse ndërhyrja në fjalë ndiqte një “*qëllim të ligjshëm*” ose ishte “*e domosdoshme në një shoqëri demokratike*”²⁷. Në çështjen *Mozer kundër Republikës së Moldavisë dhe Ruisë*, Gjykata gjeti se, pavarësisht në se kishte një bazë ligjore për ndërhyrje në të drejtat e kërkuesit, ndërhyrja nuk ishte në përputhje me kushtet e tjera të

²⁵ Shimovolos kundër Ruisë, § 68.

²⁶ Söderman v. Sweden [GC], § 117.

²⁷ M.M. v. Hollanda, § 46; Solska dhe Rybicka v. Poland, § 129.

përcaktuara në nenin 8/2 (196 §) Ndërhyrja gjithashtu mund të konsiderohet se nuk është “në përputhje me ligjin”, si rezultat i një mase të paligjshme sipas nenit 5 § 1²⁸.

Gjykata ka vërejtur megjithatë se praktika e saj duhet të jetë mjaft e përmbledhur kur verifikon ekzistencën e një qëllimi të ligjshëm brenda kuptimit të paragrafëve të dytë të neneve 8 deri 11 të Konventës²⁹. Fakt është që Qeveria apo Shteti i paditur duhet të tregojë/dëshmojë se ndërhyrja ndjek një qëllim të ligjshëm³⁰.

Në çështjen *Malone kundër Mbretërisë së Bashkuar*³¹, Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut mori në shqyrtim rregullat e atëhershme britanike në lidhje me autorizimin e përgjimit dhe të regjistrimit të telefonave, i cili bëhej pas dhënies së një autorizimi nga ana e ministrit përkatës. Rezultoi se procedura për të arritur në paralajmërime të tilla parashikohej nga “*Rregulla*” (akte nënligjore) të cilat lejonin një diskrecion shumë të gjerë, sa që ishin në fakt të pakufizuara në lidhje me qëllimin për të cilin mund të lejohej përgjimi. Si rrjedhim Gjykata vendosi se sistemi i Mbretërisë së Bashkuar shkelte nenin 8 duke mos qenë në përputhje me ligjin.

Nevoja për një kujdes të vazhdueshëm në këtë fushë del qartë në pah edhe nga vendimi i Gjykatës në lidhje me çështjen *Halford kundër Mbretërisë së Bashkuar*³². Kërkesja në këtë çështje, një oficer e lartë policie, ankohej sepse telefonatat e saj në zyre përgjoheshin. Gjykata konstatoi se edhe një herë tjetër se Mbretëria e Bashkuar kishte shkelur nenin 8 të Konventës, përderisa legjislacioni i posaçëm që rregullonte sistemin e përgjimit të telefonave,³³ nuk mund të zbatohet ndaj telefonatave private, në të njëjtën mënyrë si ai që zbatohet në lidhje me telefonatat nga zyra e kërkueses.

²⁸ Blyudik kundër Ruisë, § 75.

²⁹ SAS k. Francës [GC], § 114.

³⁰ Mozer kundër Republikës së Moldavisë dhe Ruisë, § 194; P.T. v. Republika e Moldavisë, § 29.

³¹ Vendim i Gjykatës i 2 gushtit 1984, Seria A, Nr. 31.

³² Vendim i GJEDNJ-së i 25 qershorit 1997.

³³ Aq më tepër që ky legjislacion ishte miratuar nga ana e Parlamentit Britanik në vijim të vendimit të Gjykatës në lidhje me çështjen *Malone kundër Mbretërisë së Bashkuar*.

Ndërsa, në çështjet *Khan kundër Mbretërisë së Bashkuar*³⁴ dhe *P.G. & J.H. kundër Mbretërisë së Bashkuar*³⁵ u konstatuan shkelje në lidhje me mungesën e bazës ligjore për kryerjen e përgjimeve.

Në kohën e ngjarjeve të çështjes *Khan dhe Taylor Sabori kundër Mbretërisë së Bashkuar*³⁶ nuk kishte ndonjë rregullim ligjor mbi përdorimin e aparaturave të përgjimit dhe regjistrimit nga ana e policisë. Gjykata vendosi se ligji duhet të jetë i qartë në mënyrë të mjaftueshme me qëllim që të mund t'ju japë individëve tregues të përshtatshëm, në lidhje me rrethanat dhe kushtet në të cilat autoritetet publike kanë të drejtë të përdorin aparatura të tilla. Në çështjen *P.G. & J.H.*, Gjykata vuri në dukje se nuk kishte ndryshim material për sa i përket faktit në se përgjimi dhe regjistrimi janë bërë pa dijeninë ose pëlqimin e individit. **Gjykata theksoi se edhe në një rast të tillë, gjen zbatim po njësoj parimi themelor sipas të cilit, e drejta e brendshme duhet të ofrojë mbrojtje kundër arbitraritetit dhe abuzimeve në përdorimin e teknikave të përgjimit dhe regjistrimit**³⁷.

Gjykata e ka vlerësuar si të rëndësishme që një person të mund të zbulojë, pas marrjes fund të përgjimit të tij, në se ai ka qenë objekt përgjimi dhe në se e sheh të nevojshme të kundërshtojë edhe vlefshmërinë e këtij veprimi të ndërmarrë ndaj tij, megjithëse njoftimi *post facto* nuk është një kërkesë e domosdoshme në çdo rast, për shkak se në disa raste “*mos bërja e një njoftimi të tillë ka për qëllim të sigurojë efikasitetin e ndërhyrjes.*”³⁸ Komisioni ka mbajtur qëndrimin se kjo gjë nuk mund të lejohet vetëm në rastet kur “*një informacion i tillë do të rrezikonte të kompromentonte qëllimin dhe objektin e masës së përgjimit të telefonave*”.³⁹

³⁴ Vendim i 12 majit 2000.

³⁵ Vendim i 25 shtatorit 2001.

³⁶ Vendim i 22 tetorit 2002.

³⁷ Shih gjithashtu vendimin e 16 korrikut 2002 në lidhje me çështjen *Armstrong kundër Mbretërisë së Bashkuar*.

³⁸ Shih Raportin e Komisionit në lidhje me çështjen *Spillman kundër Zvicrës*.

³⁹ *Ibid.*

Avokati i Popullit vlerëson se në rastin konkret të ligjit objekt kërkesë pranë Gjykatës Kushtetuese, njoftimi përbën një nga momentet thelbësore, për ushtrimin e garancive që individit gëzon, nga legjislacioni procedural penal.

Një “*akuzë penale*” i atribuohet një personi nga momenti kur ai njoftohet zyrtarisht nga autoriteti kompetent për një pretendim se ka kryer një vepër penale, ⁴⁰.

Në çështjen *Liberty dhe të tjerët k. Mbretërisë së Bashkuar*⁴¹, aplikantët, një organizatë britanike dhe dy irlandeze për liritë civile, pretenduan se, midis viteve 1990 dhe 1997, telefonat, faksi, e-maillet dhe komunikimi i të dhënave, përfshirë informacionin ligjërish të privilegjuar dhe konfidencial, u përgjuan nga një Instrument Testimi Elektronik i drejtuar nga Ministria Britanike e Mbrojtjes. Ata kishin depozituar ankesa në Gjykatën e Përgjimit të Komunikimit, dhe pranë Drejtorit të Prokurorive Publike dhe Tribunalit të Fuqive Hetuese, për të hetuar ligjshmërinë e pretenduar të përgjimit të komunikimeve të tyre, por pa rezultat. Gjykata vendosi që kishte pasur një shkelje të nenit 8 të Konventës. ***Ajo konsideroi që ligji i brendshëm në kohën përkatëse nuk tregonte me qartësi të mjaftueshme, në mënyrë që të sigurote mbrojtje të përshtatshme kundër abuzimit të pushtetit, fushëveprimin ose mënyrën e ushtrimit të gjykimit shumë të gjerë, të dhënë autoriteteve për të përgjuar dhe ekzaminuar komunikimet e jashtme. Në veçanti, ajo nuk përcaktoi, siç kërkohet nga praktika gjyqësore e Gjykatës, në një formë të arritshme për publikun ndonjë tregues të procedurës që duhet ndjekur për zgjedhjen për ekzaminim, në, ruajtjen dhe shkatërrimin e materialit të përgjuar. Ndërhyrja në të drejtat e aplikantëve sipas nenit 8, nuk ishte në përputhje me ligjin.***

Ndërsa në çështjen *Roman Zakharov kundër Ruses*⁴², Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut vendosi që kishte pasur një shkelje të nenit 8 të Konventës, duke gjetur se dispozitat ligjore ruse që rregullojnë përgjimin e komunikimeve ***nuk parashikonin***

⁴⁰ Shih Ibrahim dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar [GC], nr. 50541/08 dhe 3 të tjerë, § 249, 13 Shtator 2016.

⁴¹ Vendim i datës 01.10.2008, Liberty dhe të tjerë kundër Mbreterise se Bashkuar (Application no. 58243/00), shih në <https://hudoc.echr.coe.int/fre#%7B%22itemid%22%3A%5B%22001-87207%22%7D>

⁴² Vendim i datës 4 dhjetor 2015 (Dhoma e Madhe), Case of Roman Zakharov kundër Ruses, (Application no. 47143/06),

garanci të përshatshme dhe efektive kundër arbitraritetit dhe rrezikut të abuzimit, i cili ishte i natyrshëm në çdo sistem të mbikëqyrjes sekrete dhe i cili ishte veçanërisht i lartë në një sistem të tillë si në Rusi, ku shërbimet sekrete dhe policia kishin qasje të drejtpërdrejtë, me mjete teknike, në të gjitha komunikimet e telefonisë celulare. Në veçanti, Gjykata gjeti mangësi në kornizën ligjore në fushat e mëposhtme: rrethanat në të cilat autoritetet publike në Rusi janë të autorizuar të përdorin masa të mbikëqyrjes sekrete; kohëzgjatjen e masave të tilla, veçanërisht rrethanat në të cilat ato duhet të ndërpriten; procedurat për autorizimin e përgjimit, si dhe për ruajtjen dhe shkatërrimin e të dhënave të përgjuara; mbikëqyrja e përgjimit. Për më tepër, efektiviteti i mjeteve juridike në dispozicion për të kundërshtuar përgjimin e komunikimeve u minua nga fakti që ato ishin në dispozicion vetëm për personat që ishin në gjendje të paraqisnin prova të përgjimit dhe se marrja e një prove të tillë ishte e pamundur në mungesë të ndonjë sistemi njoftimi, ose mundësisë së qasjes në informacion në lidhje me përgjimin.

Ky shqetësim dhe rrezik i cënimit të rëndë të të drejtave të njeriut paraqitet edhe në rastin konkret në Shqipëri përmes ndryshimeve që i janë bërë ligjit objekt kërkesë para Gjykatës Kushteuese. Raste të tilla analoge janë shqyrtuar dhe trajtuar në vijim nga GJEDNJ për përgjimet lidhur me procedimet penale⁴³.

Një rëndësi të veçantë për rastin e parashtruar nga ana e Avokatit të Popullit lidhur me ndryshimet në ligjin “Për Policinë e Shtetit”, është edhe çështja *Szabó dhe Vissy kundër Hungarisë*⁴⁴, e cila kishte të bënte me legjislacionin hungarez për mbikëqyrjen sekrete anti-terroriste të prezantuar në vitin 2011. Ankuesit u ankuan në veçanti se ata mund t’i nënshtroheshin masave të paarsyeshme dhe disproporcionale ndërhyrëse brenda kornizës ligjore hungareze mbi mbikëqyrjen sekrete për qëllime të sigurisë kombëtare (domethënë, “neni 7 / E (3) mbikëqyrje”). Ata theksuan veçanërisht se kjo kornizë ligjore ishte e prirur për abuzim, veçanërisht për mungesë kontrolli gjyqësor. Në këtë rast,

⁴³ Shih çështjet Akhlyustin kundër Rusisë, Zubkov dhe të tjerë kundër Rusisë, dhe Konstantin Moskaev kundër Rusisë, vendime të datës 7 Nëntor 2017.

⁴⁴ Vendim i datës 12 janar 2016, Szabó and Vissy v. Hungary, no. 37138/14, § 73, ECHR 2016.

Gjykata vendosi që kishte pasur një shkelje të nenit 8 të Konventës. Ajo pranoi që ishte një pasojë e natyrshme e formave të marra nga terrorizmi i sotëm, që qeveritë të përdorin teknologjitë më të fundit, duke përfshirë monitorimin masiv të komunikimeve. Sidoqoftë, *Gjykata nuk ishte e bindur që legjislacioni në fjalë ofron masa të mjaftueshme mbrojtëse për të shmangur abuzimet. Veçanërisht, fushëveprimi i masave mund të përfshijë praktikisht cilindo në Hungari, me teknologji të reja, që i mundësojnë Qeverisë të administrojë lehtësisht volume të mëdha të dhënash në lidhje edhe me persona jashtë fushës fillestare të veprimit.* Për më tepër, urdhërimi i masave të tilla, po ndodhte tërësisht brenda sferës së ekzekutivit dhe pa një vlerësim në se përgjimi i komunikimeve ishte rreptësisht i domosdoshëm, si edhe pa ndonjë masë përmirësuese efektive, e aq më pak ato gjyqësore, që aplikoheshin në atë shtet.

Vendimi i Seksionit të Katërt të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në çështjen Szabó dhe Vissy kundër Hungarisë, ka ngritur përsëri pikëpyetje mbi ligjshmërinë e qeverive për të përdorur teknologji të reja për të kryer gjerësisht mbikëqyrjen e qytetarëve të saj, në emër të “*sigurisë kombëtare*”. Kjo çështje thekson tensionin dhe raportin, midis të drejtës së qytetarëve për privatësi dhe aftësinë në rritje të qeverisë për të përgjuar, në një epokë ku më shumë të dhëna personale se kurrë më parë, ruhen dhe komunikohen përmes mjeteve elektronike.

Kontrolli gjyqësor dhe subjekti që do t’i nënshtrohet procedurave të përgjimit, është trajtuar dhe interpretuar edhe në çështjen *Hambardzumyan kundër Armenisë*.⁴⁵ Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vendosi njëzëri, se kishte pasur një shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut. Çështja kishte të bënte me ankesën e kërkuarit, që policia nuk kishte pasur një urdhër gjyqësor të vlefshëm, për të vendosur atë nën mbikëqyrje sekrete, gjatë një hetimi penal. Gjykata gjeti në veçanti se *urdhri nuk kishte qenë mjaft specifik për personin, i cili ishte objekt i masës së vëzhgimit, paqartësi e cila ishte e papranueshme kur bëhej fjalë një ndërhyrje të tillë serioze në të drejtën për të respektuar jetën private*

⁴⁵ Kërkesa nr. 43478/11

dhe familjare, si mbikëqyrja e fshehtë. Për më tepër, urdhri nuk kishte renditur masat specifike, që do të kryheshin kundër aplikuesit. Në përgjithësi, masa e mbikëqyrjes nuk kishte kontroll të mjaftueshëm gjyqësor dhe kishte qenë në konflikt me Konventën.

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut ka përsëritur në mënyrë të vazhdueshme se bisedat telefonike përfshihen nga nocionet e “jetës private” dhe “korrespondencës” brenda kuptimit të nenit 8. Monitorimi i tyre do të thotë ndërhyrje në ushtrimin e të drejtave të dikujt sipas nenit 8 të KEDNj⁴⁶. Një ndërhyrje e tillë justifikohet nga kushtet e paragrafit 2 të nenit 8, vetëm në se është “*në përputhje me ligjin*”, ndjek një ose më shumë nga qëllimet legjitime të përmendura në paragrafin 2 dhe është “*e nevojshme në një shoqëri demokratike*”, në mënyrë për të arritur qëllimin ose synimet. Parimet e përgjithshme të mëposhtme janë konsoliduar në çështjen *Roman Zakharov kundër Rusisë*⁴⁷, cituar më lart.

Formulimi i termit “*në përputhje me ligjin*” kërkon që masa apo akti i kundërshtuar të ketë një bazë në të drejtën e brendshme dhe të jetë në përputhje me shtetin e së drejtës, i cili përmendet shprehimisht në Preambulën e Konventës, por natyrshëm edhe në objektin dhe qëllimin e Nenit 8. Ligji duhet të përmbushë kërkesat e cilësisë: ai duhet të jetë i arritshëm për personin në fjalë dhe i parashikueshëm për efektet e tij.

Për më tepër, meqenëse zbatimi në praktikë i masave të mbikëqyrjes sekrete të komunikimeve nuk është i hapur për shqyrtim nga individët e interesuar ose publiku në përgjithësi, diskrecioni ligjor, njohur ekzekutivit ose gjykatësit që të shprehet në terma të një fuqie të pakufizuar, do të ishte në kundërshtim me parimin e sundimit të ligjit. Si pasojë, ligji duhet të tregojë fushën e çdo diskrecioni të tillë të dhënë autoriteteve kompetente dhe mënyrën e ushtrimit të tij me qartësi të mjaftueshme për t’i dhënë individit mbrojtje të përshtatshme ndaj ndërhyrjeve arbitrare⁴⁸.

⁴⁶ Shih *Malone kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 2 gusht 1984, § 64, Series A no. 82. Ky standard është ritheksuar edhe në çështjen *Liblik dhe të tjerë kundër Estonisë*, shih <https://hudoc.echr.coe.int/fre#%22itemid%22:%22001-193251%22>}, Aplikimi nr 173/15, vendim i datës 07.10.2019.

⁴⁷ Shih §§ 228-234 të këtij vendimi dhe referencat e mëtejshme të renditura në të.

⁴⁸ Ibid.

c) Nenin 116 të Kushtetutës në të cilin është sanksionuar hierarkia e akteve normative që kanë fuqi të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, sepse sikurse parashtruam edhe më sipër bie ndesh me parashikimet e Kodit të Procedurës Penale.

Për sa kohë që përgjimi dhe mbikëqyrja e fshehtë, është pjesë e Kodit të Procedurës Penale, i cili është miratuar me shumicë të cilësuar prej 3/5 e votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit, strukturat e Policisë së Shtetit në veprimtarinë e tyre, duhet ta zbatojnë atë në mënyrë korrekte.

Në se vlerësohet që për mbarëvajtjen e punës dhe kryerjen e misionit ligjor të Policisë së Shtetit, nevojitet përmirësimi i formave dhe metodave të përgjimit, mbikëqyrjes dhe gjurmimit, ato duhet të bëhen në Kodin e Procedurës Penale dhe jo në ligjin e saj organik.

Kujtojmë që legjislacioni procedural penal ka për detyrë ndër të tjera, të mbrojë liritë personale dhe të drejtat e interesat e ligjshme të shtetasve. Parimi i ligjshmërisë dhe i kushtetueshmërisë nënkupton respektimin dhe zbatimin e detyrueshëm të normave, të cilat burojnë nga Kushtetuta, si dhe nga ligjet e tjera. Në legjislacionin ndërkombëtar që vendi ynë ka miratuar, Kushtetutë dhe veçanërisht në ligjet e veçanta, parashikohen detyra konkrete për subjektet e procedimit penal, për të gjitha fazat e procedimit, ndaj plotësimi i legjislacionit, ndër të tjera duhet të respektojë, si hierarkinë e akteve normative, ashtu edhe rregullat e teknikës legjislative, detyrime këto të cilat mendojmë se nuk janë respektuar në rastin konkret.

Parimi i shtetit të së drejtës ku mbështetet një shtet demokratik, nënkupton sundimin e ligjit dhe mënjanimin e arbitraritetit, me qëllim që të arrihet respektimi dhe garantimi i dinjitetit njerëzor, drejtësisë dhe sigurisë juridike. Disa nga elementet e shtetit të së drejtës, që kanë të bëjnë me objektin e këtij shqyrtimi kushtetues janë: parimi i ndarjes së pushteteve, miratimi i ligjeve në përputhje me Kushtetutën, mbështetja e veprimtarisë së organeve ekzekutive vetëm në ligj, kontrolli i administratës, garantimi i të drejtave dhe lirive themelore dhe parimi i sigurisë juridike.

Parimi i shtetit të së drejtës i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës, nënkupton veprimin e të gjithë institucioneve shtetërore sipas së drejtës në fuqi, si dhe supremacinë e Kushtetutës ndaj akteve të tjera normative.⁴⁹ Çdo organ në një shtet të së drejtës, duhet të veprojë për atë që e lejon Kushtetuta dhe ligji, duke mos i tejkaluar kufijtë e përcaktuar prej tyre. Në këtë kuptim, çdo institucion shtetëror duhet të ketë të përcaktuar qartë fushën e kompetencave të veta brenda të cilave është i autorizuar të veprojë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore⁵⁰.

Për sa parashtruar dhe argumentuar më sipër, bazuar në nenet 7, 17, 116, 131/a, 134/1/ç të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar; nenin 8 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 45/1, 49/1, 50/1 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenin 24/c të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar,

K Ë R K O J M Ë:

1. Pranimin e kësaj kërkesë.
2. Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut, të nenit 8 të ligjit nr. 133/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” - të ndryshuar”, pasi cenon rëndë të drejtat kushtetuese e ligjore të shtetasve.

⁴⁹ Neni 4: “1. E drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit. 2. Kushtetuta është ligji më i lartë në Republikën e Shqipërisë. 3. Dispozitat e Kushtetutës zbatohen drejtpërsëdrejti, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe”.

⁵⁰ Shih vendimin nr. 15 datë 15.04.2010 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

3. Pezullimin e menjëhershëm të zbatimit të neni 8 të ligjit nr. 133/2020, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar”, derisa vendimi përfundimtar i Gjykatës Kushtetuese të hyjë në fuqi, me qëllim parandalimin e pasojave që mund t’u shkaktohet shtetasve nga aplikimi i masave të veçanta nga strukturat e Policisë së Shtetit.

**KËRKUESI
AVOKATI I POPULLIT**

ERINDA BALLANCA

